



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:094214

C. nr. 1320/2023

Datë: 05.02.2024

Numri i dokumentit: 05374441

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen kontestimore, sipas padisë së paditësve N. (S) O., S.E., A.E., E.B. që të gjithë nga Prizreni, dhe S. (S) M. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. N.M. nga Prizreni, kundër të paditurve: S. (N) B., S.B., H. (N) B., A. (N) B., Sh. (N) B., N.(N) B., A. (N) B. dhe A. (N) R. që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson avokati B.Sh. nga Prizreni, për caktimin e masë së sigurimit, pas seancës, më datën 30 Janar 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet propozimi i paditësve me të cilin kanë kërkuar “*të caktohet masa sigurimit për ngastrat kadastrale P-71813068-06681-0, P-71813068-05206-3, P-71813068-05206-1, P-71813068-05206-7, P-71813068-05206-4, P-71813068-05206-6, P-71813068-05206-5 dhe P-71813068-05206-0, ZK Prizren*”, si kërkesë e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësit në këtë gjykatë kanë parashtruar padi kundër të paditurve për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, sipas bazës të drejtës së trashëgimisë dhe kanë propozuar caktimin e masës së përkohshme të sigurimit me të cilën obligohen të paditurit të mos ndërmarrë kurrfarë veprimesh, siç është ndryshim, tjetërsim, bartja e të drejtave pronësore apo ndryshimi në regjistrat kadastrale për ngastrat kadastrale: P-71813068-06681-0, P-71813068-05206-3, P-71813068-05206-1, P-71813068-05206-7, P-71813068-05206-4, P-71813068-05206-6, P-71813068-05206-5 dhe P-71813068-05206-0, ZK Prizren, me të cilat veprime do të dëmtohet apo ndryshohet gjendjen ekzistuese dhe se pa caktimin e masës së përkohshme të sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesëpadisë.

Në seancë pala paditëse ka ngelur në tersi si në propozimin për caktimin e masë së përkohshme, duke sqaruar edhe njëherë se me rastin e zhvillimit të procedurës së trashëgimisë, pala e paditur nuk ka dhënë të dhëna të sakta për trashëgimtarët ligjore të tani të ndjerit sabrit bajrami, pasi që përveç djemve N. dhe N.B. tani i ndjeri S. ka lënë edhe tri vajza dhe atë N.O., S.M. dhe të ndjerën B.E. e cila pas vetës ka lënë fëmijët S.E., A.E. dhe E.E.

Gjithashtu sqaron që palët e paditura në njërën nga ngastrat kadastrale janë duke u zhvilluar punimet ndërtimore me lejen e të paditurve. Sqaron që në kontratën për ndarjen e pasurisë gjatë jetës, kemi të bejm me ngastra të cilat gjeden në fshatrat ndërsa padia e ushtruar ka të bëjë me ngastrat që janë marr në vitin 1964 dhe më vonë janë kthyer nga PIK Progres, në vitin 1992.

Gjykata këtë seancë e ka mbajtur në mungesë të palës së paditur, pasi që ka pasur prova se pala është thirr në mënyrë të rregullt. Ndërsa gjykata nuk ka miratuar kërkesën e palës

së paditur që atë seancë ta shtyjë për datë tjetër, pasi që kërkesës nuk i është bashkangjitur asnjë provë për arsyet e shtyrjes. Ndërsa në anën tjetër për datën e seancë pala e paditur është njoftuar në seancën e kaluar ku e njëjta edhe është sqaruar që për datën 30.01.2024, kur është mbajtur seanca është datë e lirë për të.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me arsyet për caktimin ose jo të masë së sigurimit, gjykata ka administruar provat: me shikim në aktvdekjen e datës 08.12.1997 për tani të ndjerin S.B. me shikim në aktvdekjen e datës 18.04.2003 për S.B. me shikim në kontratën për ndarjen e pasurisë së përbashkët gjatë jetës Posl.OV.br.1014/72 datë 02.X.1972 dhe me shikim në fotodokumentacion.

Nga aktvdekja e datë 08.12.1997 për S.B. vërtetohet që paraardhësi i palëve ndërgjyqëse S.B. ka vdekur me datë 06.04.1984 dhe pas veti ka lënë fëmijët N.B.1., N.B.2., N.O., S.M. nipërit dhe mbesat S.E., E.E., A.E.

Nga aktvdekja e datë 18.04.2003 gjithashtu për S.B. vërtetohet që S.B. ka vdekur me datë 06.04.1984 dhe pas veti ka lënë djalin N.B. ren Sh.B. nipat S.B.1., S.B.2., H.B., A.B. dhe mbesën Sh.B.

Nga kontrata për ndarjen e pasurisë gjatë jetës Posl.ov.br. 1014/72 datë 2.X.1972, vërtetohet që tani i ndjeri S.B. ka ndarë pasurin gjatë jetës me vëllain e tij I.B. dhe dy djemtë e S.N.B. dhe N.B. nga kjo provë tani për tani nuk mund të vërtetohet për cilat ngastra bëhet fjalë pasi që shënimet kadastrale janë marr në kohën e lidhjes së kësaj kontrate pra në vitin 1972.

Nga fotodokumentacioni vërtetohet që në njërin nga ngastrat kontestuese kanë filluar punimet ndërtimore me lejen e të paditurve. Ky fakt nuk është kontestuar nga pala e paditur në seancat paraprake.

Nga provat e administruara dhe nga shtjellimi i në tersi i propozimin për caktimin e masë së sigurimit, gjykata vendosi të anulon vendimin me të cilin ka caktuar masën e përkohshme të sigurimit.

Në kuptimtë nenit 297 të LPK-së, masa e sigurimit mund të caktohet nëse propozuesi i masë së sigurimit e benë të besueshme ekzistimin e kërkesës dhe nëse ekziston dyshimi që me mos caktimin e masë së sigurimit do të vështirësohej apo pamundësohej ekzistimi i kërkesës.

Në shikim të parë për gjykatën nuk plotësohet kushti i parë për caktimin e masë së sigurimit. Pra pala paditëse nuk e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës. Nga fakti që nga dy aktvdekjet të cilat janë administruar gjatë seancës është vërtetuar që paraardhësi i palëve ndërgjyqëse, tani i ndjeri S.B. ka vdekur me datë 06.04.1984, ndërsa padia për vërtetimin pronësisë në bazë të drejtës së trashëgimisë, së bashku me kërkesën për caktimin e masë së sigurimit paraqitet me datë 24.04.2023. Pra pas 39 viteve që nga vdekja e S.B. dekujusi mbi bazën e të cilës kërkohet vërtetimi i pronësisë në bazë të trashëgimisë për trashëgimlënësin S.B.

Pasi që në kuptim të nenit 138 të Ligjit për Trashëgimin, drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet ndaj poseduesit me keqbesim brenda 20 viteve nga dita që trashëgimtari ka marrë dijeni për të drejtën e vet. Mbi

këtë bazë gjykata ka vendosur të mos cakton masën e sigurimit, pasi që pala paditëse nuk e benë të besueshme ekzistimin e kërkesës.

Pavarësisht mosplotësimit të kushtit të parë, gjykata gjen që edhe në raset se ajo e drejtë ju takon paditësve, ka mjaft ngastra tjera në të cilat pala paditëse mund të realizon të drejtat e saja, të gjitha këto në rast se e do të provonte të drejtën mbi të cilën thirret. Ashtu që çfarëdo ndërtimi nga pala e paditur, paditësit nuk do të pengoheshin në realizimin e të drejtave të tyre, në rast se atë të drejtë do ta provonte gjatë gjykimit të çështjes.

Gjykata gjithashtu me rastin e vendosjes morri parasysh edhe faktin që i autorizuari i paditësve avokati N.M. nuk ka pasur autorizim për paraqitje të padisë nga të gjithë trashëgimtarët e tani të ndjerit S.B. pasi që në seancë paditësi A.E. është sqaruar se ai pavarësisht se figuron në padi si paditës, ai nuk ka dhënë autorizim për paraqitjen e padisë, pasi që nuk është i interesuar për pjesën trashëgimore që do ti takonte sipas ligjit duke u shprehur që nuk dëshiron të merr hise në pasurinë e dajve të vet.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr.1320/2023, datë 30 Janar 2024

Gj y q t a r i
Atdhe Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, mund të paraqes ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.